



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:275361
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05699064

NË EMËR TË POPULLIT

AA.nr.678/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, A.Th, Komuna e Gjakovës, të cilin me autorizim e përfaqëson, Granit Hadërgjonaj, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës, Ministria e Financave Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimeve dhe njohjes së të drejtës në pensionin Invalid i luftës, përkitazi me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1087/2019, të datës;26.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;13.05.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1087/2019, i datës;26.04.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A A.nr.1087/2019, të datës;26.04.2023, është vendosur, *“I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, A.Th, Komuna e Gjakovës si e bazuar. II. ANULOHET vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Qeverisë së Kosovës – Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, (DFDILVC) në Prishtinë nr. i dosjes: 04-01/599, i datës 10.04.2019 dhe i datës 19.10.2018 dhe paditësit i njihet e drejta në Pension të Skemës: Invalid i Luftës – Grupi VII deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për këtë lloj pensioni. III. DETYROHET e paditura, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, që paditësit, në mënyrë retroaktive, t’ia kompensoj pagesat e perealizuara në emër të pensionit të skemës: Invalid i Luftës – Grupi VII dhe atë nga data 05.01.2018 deri më datën 25.01.2023,*

në shumën mujore e cila është aplikuar për këtë lloj pensioni, të gjitha këto brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor. IV. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet administrative të anuluar dhe ka karakter e detyrueshëm. V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.”

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura, Ministria e Financave Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë, përmes Avokaturës Shtetërore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1087/2019, të datës:26.04.2023, të prishet, dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës-Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë, nr.04-01/599, i dt.10.04.2019.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar pala paditëse, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e të paditurës, dhe i ka propozuar Gjykatës që ankesën e të paditurës ta refuzon në tërësi si të pa bazuar dhe ta vërteton aktgjykimin e kontestuar si të drejtë dhe të ligjshëm.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, A.Th ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë:08.05.2019, kundër vendimeve të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë, sepse konsideron se vendimet e kundërshtuara me padi janë të pa bazuara dhe jo të ligjshëm, për arsye se nuk është vlerësuar drejtë gjendja faktike nga ana e organeve administrative, si dhe është zbatuar gabimisht edhe ligji material, me propozim që të anulohen si i kundërligjshëm dhe të miratohet kërkesa për njohjen e të drejtës në pension invalid i luftës.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimeve të paditurës, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se “Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së – Ligji Nr. 03/L-202 dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Gjykata, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, lidhur me Invaliditetin e Luftës – dëmtimit trupor të paditësit, në shqyrtimin përgatitor, ka aprovuar propozimin e të njëjtit për nxjerrjen e provës materiale me ekspertizë mjekësore nga ekspertë të fushave përkatëse, që kërkohet me dispozitat ligjore materiale. Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27 prill 2023, ka ftuar ekspertët mjekësor, me ç’rast ekspertët, kanë sqaruar ekspertizën mjekësore duke u përgjigjur në pyetjet e gjykatës dhe të paditësit. Në bazë të ekspertizës së datës 19.01.2023 si dhe deklaratimit të ekspertëve mjekësor Dr. S.D - Ortoped, Dr.A.H - Kirurg Abdominal, Dr.F.Sh - Psikiater në seancën e datës 26 prill 2023, gjykata gjen se paditësi duke konstatuar se lidhur me lëndimet trupore të paditësit janë të shkaktuara me arme zjarri eksplozive ne regjionin e kokës te anës se djathtë po ashtu janë konstatuar lëndime trupore ne regjionin e dorës se majtë te shoqëruar me defekt lëkuror dhe deformim te gishtit te dyte te dorës e majtë, lëndimet tjera ne te dy regjionet e kofshëve ose

këmbëve duke u bazuar ne formulën e baltazarit kemi ardhur në përfundim se tek i njëjti ekziston zvogëlim i aktivitetit e përgjithshëm jetësor si pasoje e lëndime e mara ne periudhën e kohës se luftës 1998-1999 në shkallen e invaliditetit prej 23.5%. Në këtë kuptim, del që vendimi i të paditurës, është juridikisht i paqartë dhe kundërrhënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit kontestuese është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku shihet se vetëm citohen dispozitat e Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së, me shkallen e invaliditetit prej 10.00%, pa dhënë arsyetim. Gjykata, pas administrimit të provave si më lartë, pasi i ka vlerësuar një nga një provat dhe se bashku, me ekspertizën mjekësore të përpiluara nga ekspertët përkatës, si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e nga të cilat gjykata ka vërtetuar një gjendje tjetër faktike nga çfarë ka vërtetuar e paditura në procedurën administrative. Gjykata, ia fali besimin ekspertizës mjekësore të datës 26.01.2023, lidhur me shkallën e invaliditetit jetësor për paditësin, ku ekspertët e fushës ortopedike, urologe dhe psikiatrike, kanë konstatuar se shkalla e invaliditetit jetësor tek paditësi është prej 23.5%. Nga ekspertiza mjekësore e lartë cituar del se invaliditeti jetësor te paditësi është prej 23.5%, e që sipas nenit 10 par. 1.8 të Ligjit Nr. 04/L – 054, paditësi bën pjesë në grupin e VII – Invalid i Luftës së UÇK-së. Në këtë kuptim, gjykata i njohu paditësit të drejtën e përfitimit të këtij pensioni si dhe obligoi të paditurën për kompensimin e këtyre pensioneve në mënyrë retroaktive nga data e aplikimit deri në datën e ekspertizës mjekësore, si dhe për të ardhmen deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, në shumën e cila aplikohet për këtë lloj pensioni.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimit ankimor se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, sipas vlerësimit të kolegjit ky pretendim nuk qëndron, ngase e paditura të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të procedurës administrative, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit të vendimeve Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, LKA-së, dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji i apelit vëren se e paditura në ankesë edhe kësaj shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk e ka arsyetuar fare se ku qëndron vërtetimi jo i drejtë e gjendjes faktike nga Gjykata e shkallës së parë, edhe pse gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike, me ekspertizën e nxjerrë nga Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditësit, e cila është përgatitur nga tre mjekë specialist të fushave përkatëse të SHSKUK-së në Prishtinë, me datë; 19.01.2023, Dr. S.D-Ortoped, Dr.A.H-Kirurg Abdominal dhe Dr. F.Sh-Psikiatër, të cilët pasi kanë ekzaminuar paditësin dhe shkresat e lëndës, kanë dhënë mendim se “lëndimet trupore të paditësit janë të shkaktuara me arme zjarri eksplozive ne regjionin e kokës te anës se djathtë po ashtu janë konstatuar lëndime trupore ne regjionin e dorës

se majtë te shoqëruar me defekt lëkuror dhe deformim te gishtit te dyte te dorës e majtë, lëndimet tjera ne te dy regjionet e kofshëve ose këmbëve duke u bazuar ne formulën e baltazarit kemi ardhur në përfundim se tek i njëjti ekziston zvogëlim i aktivitetit e përgjithshëm jetësor si pasoje e lëndime e marra ne periudhën e kohës se luftës 1998-1999 në shkallen e invaliditetit prej 23.5%..”, e të cilën ekspertizë nuk e ka kundërshtuar e paditura me ndonjë parashtresë pas dorëzimit të saj me dt.16.03.2023, e as në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.26.04.2023, e në të cilat është thirrur në mënyrë të rregullt dhe nuk ka marrë pjesë. Prandaj, kolegji i apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, për faktin se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Kurse sa i përket pretendimit tjetër ankimor se Gjykata e shkallës së parë “*Me rastin e vendosjes Gjykata nuk pati parasysh se vlerësimet e komisioneve mjekësore të MPMS-së...*”, të njëjtin pretendim kolegji i apelit e vlerësoi si të pa bazuar për faktin se ekspertiza mjekësore është e qartë dhe nuk ka kontradiktë në vete, dhe se e paditura nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re, as para seancës së shqyrtimit kryesor me ndonjë parashtresë, e as në seancë, në të cilën është thirrur në mënyrë të rregullt dhe nuk ka marrë pjesë, e cila eventualisht do ta vërtetonte të kundërtën nga ajo që është dhënë në ekspertizë. Prandaj, të njëjtat pretendime janë të paqëndrueshme dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Gjykata e shkallës së parë.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se Gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, kolegji i apelit nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se i njëjti është i pa qëndrueshëm dhe i pa argumentuar me prova konkrete të cilat do të gjente mbështetje ligjore, dhe si i tillë është pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Gjykata e shkallës së parë, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, përkatësisht, nenin 10 të Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmoreve, Veteraneve dhe Pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i apelit. Prandaj ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.678/2023, datë;13.05.2024

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti